

Nga: Komisioni Ad Hoc i ngritur nga IEKA per projektin ligjin e ri te auditimit
Drejt: Kryetarit te Keshillit te Drejtimit
Per Dijeni: Anetareve te Keshillit te Drejtimit dhe Drejtorit Ekzekutiv
Subjekti: Memo per pikat kryesore te projektligjit te ri te auditimit
Date: 26.09.2024

Pershendetje kryetar i KD dhe anetare te KD,

Ne vijim te Asamblese, u emërua nje komision ad hoc nga ju per te kontribuar ne procesin e politikeberjes persa i përket ndryshimeve ne ligjin e auditimit nga Ministria e Financave. Projektligji e ka mbaruar procesin e konsultimeve dhe ka kaluar ne komisione parlamentare. Disa prej pikave te mbrojtura janë reflektuar dhe per kete eshte per t'u vlerësuar pasi janë reflektime me vlere per profesionin tone. Megjithate, ka disa çështje qe vazhdojnë te jene akoma problematike ne gjykimin tone, qe na cenojnë punën e përditshme, rrisin kostot e auditimit dhe heqin fuqine ligjore nga IEKA, duke e dobësuar akoma me shume IEKA dhe duke forcuar akoma me shume BMP, per te cilat ne kemi bere nje përmbledhje si vijon:

1. Siç permendet nenit 20, pika 2, të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike të klasifikuara të mëdha dhe NJEIP, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, detyrohen ta kryejnë auditimin vetëm nëpërmjet shoqërive audituese. Për shoqëritë audituese që angazhohen në auditimin e njësive ekonomike të mëdha dhe NJEIP do të përcaktohen kriteret shtesë me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Ketu verehen 2 ceshtje me rendesi qe cenojne direkt Kushtetuten

Se pari, sipas Nenit 11 te Kushtetutes, kufizimet e lirise ekonomike mund te vendosen vetem me ligj dhe per arsye madhore me rendesi publike. Ne kete rast, kriteret shtese qe do te percaktohen me VKM jane te pavlefshme, pasi kufizimet nuk imponohen kurre me ane te VKM, por vetem me ligj.

Se dyti, nga ana tjeter, ligji nuk mund te jete diskriminues ne raport me menyren sesi organizohet audituesi ligjor, apo subjektivitetin qe ka Ministri i Financave apo Kryeministri ne lidhje me percaktimin e kriterëve shtese qe jane anti-kushtetuese bazuar ne nenet 11, 17 dhe 18 te Kushtetutes, pasi cenojne lirine e veprimtarise ekonomike, demtojne konkurrencen duke favorizuar qartesisht nje kategori audituesish dhe prodhojne diskriminim midis audituesve, te cilet kane kaluar te njejtin proces marrje titulli Audituesi Ligjor. Pergjegjësia finale eshte e audituesit ligjor per te kryer punen ne perputhje me ligjet dhe per te garantuar cilesine e auditimit.

Ne vijim, ne asnje nga nenet e Direktives, Ne nuk e kemi gjetur dicka te tille. Psh nese audituesi X ka punuar ne nje kompani BIG4 dhe ka bere angazhimin e nje PIE, dhe ne nje moment te dyte vendos te hape zyren e tij, pse mund te mos konkurroje per te njejtin klient qe e ka bere kur ka qene i punesuar,

dhe kur i ka aftesite dhe eksperiencen e fituar nga angazhimi me BiG4 ? Si mund te ndikojne forma e organizimit apo kriteret shtese ne kete ceshtje?!

Keto dispozita ndikojne ne shtremberimin e profesonit te audituesit dhe denigrimit te drejtave dhe fuqise qe mban licenca e audituesit ligjor ne rastin ku aplikuesi i profesionit eshte organizuar ligjerisht ne formen e Personit Fizik. Praktika e perzgjedhjes se audituesit – te organizuar si shoqeri apo si Person Fizik eshte teresisht atribut i Qeverisjes se Shoqerive qe Auditohen.

2. Në nenin 4/1, pika 1, eshte shtuar nje tarife per 1.5 % mbi shumen e faturuara per njesite ekonomike jo me interes publik (*gje e cila nuk ishte ne draftin e l-re te diskutuar para mbledhjes se kryer me perfaqesues te Ministrise se Financave*) .

Se pari, eshte kompetence e IEKA-s sipas pikes 2.1.4 te Statutit “*te organizoje sistemin e kontrollit te cilesise se punes te audituesve ligjore kur kjo detyre i delegohet nga Bordi. Te kryeje investigime te nevojshme per rastet e shkeljeve te standarteve teknike dhe te etikes profesionale si dhe te udheheqje sistemin e Investigimit e te disiplines*. IEKA ka ne strukturen e saj 2 kontrolore te punesuar dhe burimet njerezore dhe praktikantet e kontrollit kane qene gati me kohe, gje e cila e angazhon ate (IEKAn) ne kontrollin e Njesive PA interes publik. Dhe pagesat e anetareve (60,000 leke tarife fikse dhe 0.3%-0.5% mbi faturimin vjetor te çdo subjekti Auditues ligjor – paguhet jo vetem per trajnimet, por qe IEKA te kryeje te gjitha detyrat dhe detyrimet statutores te saj. Kjo tarife tashme paguhet njehere dhe kerkesa sipas nenit 4/1, pika 1, eshte e pakuptimte dhe ngarkese financiare renduese dhe e pa drejte te paguhet per here te dyte Institucionit te BMP.

Se dyti, Kjo rendese e kostove te audituesit eshte efektivisht me e larte se % e deklaruar pasi nese do te llogarisim nje marzh fitimi neto prej 50%, llogaritet qe kjo tarife te arrije 3% e fitimeve neto, pervec gjithese pagesave te tarifave te permendura si me poshte;

- per IEKAn; Lek 60,000 tarife fikse dhe 0.3%-0.5% mbi faturimin vjetor , dhe
- per BMP 3% mbi faturimin per angazhimet me njesite me Interes Publik

Shtesa e pretenduar prej 1.5% e faturimit per njesite pa Interes publik eshte pertej çdo lloj arsyesimi dhe gjithashtu mbivendosje/ mbipagese e papranueshme per financat e audituesve ligjore.

3. Siç eshte vene re gjate ketyre viteve, ka shume shoqeri dhe grupe ekonomike qe detyrohen te auditohen por nuk e pranojne dhe nuk kryejne auditim. Te konsiderohet mundesia qe te aplikohen gjoba per njesite ekonomike dhe grupet ekonomike qe kane detyrimin per te kryer auditime ligjore sipas kriterëve te percaktuara, dhe keto gjoba te jene te konsiderueshme per te demotivuar njesite apo grupet ekonomike nga moskryerja e auditimit. Momentalisht eshte vetem gjoba prej 60,000 lekesh ne QKB per mosdorezim raportit ne kohe, por kjo vlere e ben njesine teresisht te njeanshme ne vendimarrje, pasi kosto e auditimit minimalisht do te jete 120,000 leke, keshtu qe shume shoqeri apo grupe ekonomike zgjedhin te mos e bejne.

4. Te rishikohet koncepti i buxhetimit te BMP-se. Organet shtetërore të vlerësojnë ekzistencën e Bordit të Mbikqyrjes si njësi ekonomike e pavarur nga IEKA, dhe pjese e buxhetit te shtetit - pasi krijon ngarkesa të panevojshme mbi kostot e auditimit. Ka nje konflikt interesi si pasojë e financimit të drejtpërdrejtë nga audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit dhe organizatat profesionale. Pra, te jete nje entitet buxhetor ne varesi te MF dhe te mos krijoje varesi materiale te financat e shoqatave profesionale. Ne lidhje me kete ceshtje, ka shume vende brenda dhe jashte Bashkimit European qe ndjekin nje praktike te tille dhe Ne mendojme qe pershtatet per nje treg si Shqiperia.

Nga ana tjetër, nese audituesit ligjor direkt ose indirekt nepermjet IEKA financojne BMP, ky fakt i pozicionon audituesit ligjore te jene ne rolin e organit vendimarrës, per BMP-ne (siç edhe te IEKA) Ne momentin qe BMP financohet nga audituesit ligjor, atehere eshte Asambleja e ketij te fundit qe duhet te kete ndikim dhe te marre vendime mbi organizimin dhe operacionet dhe veprimet e BMP. Gje qe qartesisht nxjerre ne pah konfliktin e pastër te interesit.

5. Duke qene se BMP ka kompetence te saj edhe mbikqyrjen e kontabilistëve te miratuar, ne dispozitat e projektit te ri vihet re nje trajtim i pa-barabarte midis kontabilistëve dhe audituesve e bazuar ne nje diskriminim financiar apo profesional. Kontabilistet kane shume me pak ngarkese profesionale, dhe e vetmja menyre sesi e financojne BMP eshte indirekt nepermjet IKM. Nderkohe qe audituesit ligjore e financojne nepermjet IEKAs, dhe direkt per shoqerite me interes publik, dhe tashme kerkohet edhe 1.5% per shoqerite pa interes publik. Ne kerkojme nje trajtim me te barabarte duke lehtesuar ngarkesen e audituesve dhe duke e rritur ate te kontabilistëve ne financimin e BMP.
6. Kemi vene re qe gjithë procesi i konceptimit te ketij projektligji eshte trajtuar me nje nxitim te qellimte, aspak profesional dhe i rrezikshem per pasojat qe sjell qe gjithë subjektet auditues ligjore jashte nivelit te BIG4 dhe shoqerive ne nivele te ngjashme/aferta. Ne gjykojme qe shpejtesia e konsultimeve, dhe e hyrjes ne fuqi te ligjit, pa patur dispozita kalimtare te qarta dhe pa i dhene kohen e nevojshme konsultimit publik dhe periudhes se tranzicionit, demton gjithë praktikat korrente te pranimit, kontraktimit and zhvillimit te auditimit per vitin qe vjen, ne kushtet qe nje mase e emerimeve jane kryer ne vazhdim bazuar ne dispozitat e ligjit aktual, duke cenuar direkt sigurine juridike, nje parim i mbrojtur me Kushtetuten e Shqiperise.
7. Problematikë shohim në përkufizimin e termave edhe pse në relacionin të Projektligjit është shprehur se ndryshimet ligjore janë bërë edhe për shkak të qartësimit të terminologjive përkatëse ku janë hasur problematika, me synim unifikimin dhe përmirësimin e zbatueshmërisë së këtij ligji. Një rast është për termin “auditues ligjor i huaj” dhe termin “auditues ligjore”.

Termi “auditues ligjor I huaj” sipas projektligjit: *është individi i miratuar dhe i regjistruar për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale ose të konsoliduara, apo ku është e zbatueshme sipas kërkesave të legjislacionit përkatës në fuqi, dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të personave juridikë në një shtet tjetër.*”.

Termi “auditues ligjor” sipas projektligjit: *është individi i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore dhe ku është e zbatueshme sipas kërkesave të legjislacionit përkatës në fuqi, dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, si dhe i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.*”

Në këtë përkufizim nuk kuptohet qartë se kush është autoriteti kompetent që e miraton si auditues ligjorë I huaj, si dhe këta auditues ligjorë të huaj kanë të drejtë të kryerjen e auditim ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale ose të konsoliduara të personave juridikë e personave fizikë shqiptarë, dhe për persona juridikë në një shtet tjetër kanë të drejtë vetëm për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë??. Gjithashtu po ti referoheni përkufizimit të termit tjetër “auditues ligjorë” nuk kuptohet qartë se në këtë term a përfshihen si audituesit ligjorë të certifikuar nga autoritete shqiptare si dhe ata auditues ligjorë të huaj??

Edhe pse në ndryshimin e kuptimit të termit “shoqëri auditimi” është hequr kufizimi I formës të organizimit të shoqërive të auditimit I cili ka qënë vetëm sipas Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në Projekt ligj nuk është parashikuar ndryshim të nenit 21”Regjistrimi I shoqërive audituese” në ligjin bazë Nr. 10091, datë 5.03.2009 Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar” dhe kjo prodhuan nje moskonsistence. Pra, ne përkufizim shoqëria e auditimit mund te organizohet sipas cdo ligji, qe eshte ndryshim i propozuar. Ndersa, ne ligjin ekzistues ne nenin 21, shoqëritë e auditimit organizohen vetëm sipas ligjit 9901, qe nuk eshte perditesuar dhe prodhon moskoherence ligjore.

- 8. Kufizimet e ripërtëritjes së mandateve të organeve të drejtimit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë llogariten që nga koha kur organi përkatës është ngritur dhe ka funksionuar për herë të parë. Anëtarët e organeve të zgjedhura të organizatës profesionale të audituesve ligjorë përfundojnë mandatin, sipas afateve të parashikuara në këtë ligj.**

Për të siguruar vazhdimësinë në përbërjen dhe punën e Këshillit Drejtues të Organizatës Profesionale të Audituese Ligjorë, pas përfundimit të mandatit aktual, tre prej anëtarëve të Këshillit Drejtues, të përcaktuar me short, u shtyhet mandati për një periudhë 2-vjeçare.

Kjo pikë duhet të hiqet, pasi vazhdimësia e organit të drejtimit të përcaktohet në Statut duke parashikuar procedura të qarta lidhur me organizimin e zgjedhjeve për antarët të rinj të KD dhe afatin e konstituimit të tyre.

Po të shikohet dhe pika 16.2 e Statutit krijohet një keqkuptim lidhur me të drejtën të kandidimit të kryetarit dhe zëvendëskryetari në zgjedhjet e radhës për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit Drejtues edhe pse ju ka mbaruar afati katërvjeçar.

Në pikën 16.2 të nenit 16 të Statutit të IEKA përcaktohet:

"...16.2 Anëtarët e Këshillit Drejtues, zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve për një periudhë katërvjeçare.

Në zbatim të Ligjit 10091 ndryshuar me ligjin 47/2016, tre anëtarë, të zgjedhur për mandatin 2015-2019, të cilët përzgjidhen me short nga Këshilli Drejtues midis anëtarëve ekzistues, përfitojnë një zgjatje të mandatit edhe për dy vjet, pra deri në fund të vitit 2021. Anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues, kanë të drejtë të zgjidhen, vetëm pasi të kenë kaluar katër vjet nga zgjedhja e tyre e mëparshme. Kryetari dhe zëvendëskryetari, nese nuk përfitojnë zgjatje mandati në cilësinë e anëtarit, kanë të drejtë të kandidojnë në zgjedhjet e radhës për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit Drejtues. Nuk mund të zgjidhen respektivisht Kryetar apo zëvendëskryetar, anëtarët e KD-se, të cilët kanë shërbyer me parë, në pozicionet respektive për dy mandate katërvjeçare."

Per te gjithë këto pika, te gjithë anetaret e komisionit kane dakordesi dhe unanimisht ne kërkojmë ne baze te Statutit te IEKA, te ndiqet strategjia e mëposhtme:

1. Te diskutohet materiali me anetaret e Keshillit te Drejtimit ne nje mbledhje te protokolluar.
2. Te dërgohet materiali per mendim dhe pasurim drejt te gjithë anëtarësisë brenda ditës se hene, date 30 shtator, dhe t'u lihet afat kolegeve brenda datës 3 tetor qe te paraqiten argumente shtese apo pika te tjera qe koleget shprehin, duke qene edhe Komisioni ne dijeni.
3. Komisioni ditën e enjte, date 3 tetor do te takohet dhe do te bej nje përmbledhje finale qe do ia dergoje serish Keshillit te Drejtimit.
4. Brenda datës 4 tetor, kërkojmë nga Keshilli i Drejtimit qe ne emër te tij institucionalisht t'ia dërgoj Ministrise se Financave dhe Komisioneve Parlamentare si shkrese zyrtare.
5. Kerkojme nga KD qe te angazhoje nje jurist me pervoje dhe me eksperiencën e duhur ne menyre qe te jete pale e këtij procesi dhe ne nje moment te dyte te shikojmë mundësinë per ta cuar ne Gjykate Kushtetuese per antikushuetshtmeri te paktën ne 3 nene – neni 11, 17, 18 etj.
6. Ne vijim, kërkojmë qe ne si Komision dhe përfaqësues nga Keshilli i Drejtimit te jemi pjese aktive e komisioneve parlamentare.

Duke shpresuar ne bashkëpunimin dhe mbështetjen e te gjithë anetareve te Keshillit te Drejtimit,

Me respekt,

Anetaret e Komisionit:

Bledi Bezo

Eglina Pjeternikaj

Erjon Saraci

Leze Abazi

Julian Saraci

Vera Lala